

Asistencë teknike për sistemin e menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta për dy bashki të përzgjedhura të Shqipërisë

Konteksti

Ky projekt pason asistencën e më mëparshme ofruar në kuadër të programeve CARDS dhe IPA në mbështetje të sektorit të mjedisit dhe ndryshimit të klimës në Shqipëri.

Në një takim të Komitetit Drejtues të projektit më 31 korrik 2019, dhe mbi bazën e një rishikimi të kujdesshëm të rezultateve të arritura deri më sot dhe ndikimeve të tyre, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka kërkuar zyrtarisht mbështetjen e Delegacionit të BE-së për të zgjeruar fushën e veprimtarive ekzistuese duke përfshirë të gjithë zonën jugore të Qarkut Vlorë si dhe Zonën e Menaxhimit të Mbetjeve Gjirokastrë (siç përshkruhet në Masterplanin e vendit) duke zgjeruar kështu studimin ekzistues të fizibilitetit për të përfshirë bashkitë Himarë, Sarandë, Finiq, Delvinë si dhe Konispol.

Objektivat e projektit

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm të vendit përmes përmirësimit të kërkesave dhe menaxhimit në lidhje me mjedisin dhe ndryshimin e klimës duke u mundësuar institucioneve qeveritare të zhvillojnë, përforcojnë dhe zbatojnë legjislacionin e mjedisit dhe ndryshimit të klimës me standardet e BE-së.

Objektivat specifike të projektit:

1. Rishikimi i strategjive dhe planeve ekzistuese në nivel kombëtar në bashkëpunim të ngushtë me grupet e interesit. Zhvillimi i një studimi bazë të sektorit të mbetjeve, duke përfshirë hartëzimin e nevojave dhe infrastrukturës ekzistuese në nivel vendor.

2. Pas identifikimit të dy zonave të menaxhimit të mbetjeve (ZMM) ose "rajoneve", ku situata e sektorit të mbetjeve është më kritike, bazuar në hartën e nevojave dhe infrastrukturës (numër i lartë i venddepozitimeve ilegale, prania e mbetjeve të ndryshme të rrezikshme si dhe duke marrë parasysh aktivitetet e donatorëve dhe partnerëve të tjerë), zona e jugut të Vlorës do të vlerësohet bazuar në të njëjtën metodologji.
3. Asistencë teknike për të mbështetur bashkitë e zgjedhura në zbatimin e planeve vendore të mbetjeve, përfshirë planifikimin e operimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve të menaxhimit të mbetjeve.



Rezultatet e Projektit

1. Një vlerësim fillestar mbi statusin aktual të sektorit të mbetjeve (analiza të legjislacionit të sektorit, analiza teknike, burimet njerëzore, pajisjet, etj.) në funksion të zgjedhjes përfundimtare të dy ZMM/rajoneve për këtë projekt.
2. Planet zonale/rajonale të mbetjeve, studimet e fizibilitetit dhe hartimet paraprake për investimet e nevojshme në Sistemet e Integruara të Menaxhimit të Mbetjeve për dy

ZMM/rajonet të identifikuar.

3. Kapacitetet të përmirësuara të bashkive të përzgjedhura në planifikimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen Sistemit të Menaxhimit të Mbetjeve përfshirë ripërdorimin, riciklimin dhe reduktimin e tyre.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

DONATOR:

- EU DELEGATION

PËRFITUES:

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Bashkitë Himarë, Finiq, Delvinë, Sarandë, Konispol

KOHËZGJATJA:

- 10/2019 - 06/2020

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtor Ekzekutiv
Instituti i Kërkimeve Urbane
Rr. Asim Vokshi, Nd.14
Hyrja 11, Ap. 56
Tiranë
Tel: +355 4 2256840
E-mail: uri@uri.org.al
web: www.uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zviceran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.